



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:166855

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05082935

P.nr.2049/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dibran Jusufi dhe bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.D., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.2335/22, të datës 01.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 14.12.2023, të hapur për publikun, në prani të prokurores së shtetit Nebahate Salihu dhe të akuzuarit D.D., me datë 15.12.2023 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 18.12.2023 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari D.D., nga babai R., nëna M., e gjinisë M., i lindur me datë, në, ku edhe tani jeton në rrugën “.....”,, i pamartuar, i punësuar si tregtar në Tregun e Gjelbër në Prishtinë, ka të përfunduar shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20.04.2022, rreth orës 15:00, në rr. ”Mon Balaj”, në Prishtinë, më saktësisht në afërsi të marketit “ ETC”, gjatë një kontrole të bërë nga ana e policisë të njëjtit kanë parë të ndalur një veturë të tipit “.....”, me targa të regjistrimit të cilën e drejtonte i pandehuri D.D., pas kontrollimit tek i njëjti është gjetur një sasi e dyshuar me substancë narkotike e llojit marihuan, që pas ekzaminimit është konstatuar se te e njëjta është prezent kanabisi (Marihuana) që përmban Tetrahidrokanabinol(THC), me peshë të përgjithshme 0.44=0.0001 gram, e të cilën i pandehuri e ka poseduar pa autorizim.

-Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 9, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 242 e 364 të KPP-ës, të akuzuarin:

E GJYKON

I. Me dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind euro), të cilin dënim i akuzuari obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-ës nga i akuzuari konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë prej 0.44=0.0001 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

IV. Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet euro) dhe shumën prej 20 (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A R S Y E T I M

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 17.08.2022, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.2335/22, të datës 01.08.2022, kundër të akuzuarit D.D., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Me datë 05.12.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurorja e shtetit Nebahate Salihu dhe i akuzuari D.D.. Në këtë seancë prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

-Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar-

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

-Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit-

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar, ka kërkuar falje për veprimet e tija dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë më veprimet të tilla, se i njëjti asnjëherë më parë nuk kishte rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë. Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të

nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi lidhur me konfiskim-

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm dhe të përhershëm të substancës narkotike të llojit Marihuanë, me peshë prej 0.44=0.0001 gram, e sekuestruar nga i akuzuari. Gjykata, ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje, e as autorizim për posedimin e narkotikëve, për më tepër, substanca narkotike e lartcekur bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike, andaj gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë këtë sasi të narkotikëve, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e saj, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së dhe nenin 269 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së. Ndërsa, për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr komfor nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.2049/22, me datë 18.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.